



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 52/1 Prot.

Tiranë, më 05.02. 2024

V E N D I M

Nr. 36 , Datë 05.02. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr.2 regj, datë 11.01.2024, të paraqitur nga Qendra “ABC Tirana Club”, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z.J.M kundër Ministrisë së Kulturës, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes shoqërore*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pala ankuese, në lidhje me shpjegimin e fakteve për diskriminimin e pretenduar nga ana e saj, parashtron:

Në procesin e marrjes së informacionit nga Ministria e Kulturës, bazuar në kërkesat e ligjit nr.119/2014 “*Për të drejtën e informimit*”, më datë 26.07.2023, organizata jonë rinore i adresoi një kërkesë këtij institucioni, sipas standardeve, me tri pyetje konkrete. Duke qenë se Ministria e Kulturës nuk e ofroi shërbimin e kërkuar, pra nuk iu përgjigj asnjë prej kërkesave tona për informim, atëherë ABC Tirana Club, përballë kësaj shkelje ligjore, iu drejtua me një ankesë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (regjistruar nga kjo Zyrë me nr.1353, datë 11.08.2023)

Duhet thënë se, Zyra e Komisionerit ka bërë përpjekje përmes kontakteve me Ministrinë, prej të cilës është bërë me dije se, informacioni po përgatitej nga ky institucion publik dhe do t’i vihej në dispozicion organizatës sonë (sipas informacionit që jepet në faqen 3, paragrafi 5, në Vendimin nr.46, datë 11.10.2023 të Komisionerit). Por, Ministria sërish refuzoi ofrimin e shërbimit për organizatën tonë. Më pas vjen dhe vendimi nr.46, datë 11.10.2023, i Komisionerit, ku urdhërohej

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ministria që të vendoste në dispozicion të organizatës informacionin e kërkuar. Edhe pas vendimit nr.46, në mënyrë të pashpjegueshme Ministria e Kulturës nuk ofroi shërbimin. Në vijim të procedurave administrative, organizata jonë rinore priti 45 ditë, se mos Ministria e Kulturës e ankimonte vendimin e Komisionerit në Gjykatë. Nga interesimi ynë mbi këtë aspekt, morëm informacion jo zyrtar se, në përfundim të 45 ditëve Ministria nuk e ka ankimuar vendimin.

Kur po vlerësonim rrethanat për ta adresuar çështjen në Gjykatën Administrative, për të kërkuar sanksionimin e Ministrisë së Kulturës, sipas ligjit nr.119/2014, për refuzim të dhënies së informacionit, njihemi me një fakt që na indinjoi shumë. Ministria e Kulturës publikoi në faqen zyrtare online, një informacion që pohonte se ky institucion kishte trajtuar në fund të vitit 2023 një çështje të ngjashme (kërkesë për informacion), për një subjekt tjetër. Dhe kësaj kërkesë i kishte dhënë përgjigje(!?). Ne identifikua me rubrika “Programi i transparencës” e *website*-t të Ministrisë së Kulturës, tek shkresa në formatin PDF, e shkarkuar aty, me emërtimin “regjistri i kërkesave për informacion për periudhën Tetor-Dhjetor 2023”, se figuronte kërkesa me nr.11, datë 08.11.2023, e cila ishte e ngjashme me kërkesën e organizatës sonë. Për këtë kërkesë që ishte bërë nga një subjekt tjetër, Ministria pranonte se, e kishte dhënë të plotë shërbimin, siç dhe relatohej në Regjistër si: “Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë”.

Kujtojmë se ky shërbim iu refuzua organizatës sonë rinore, refuzim që e shikoni konkretisht të pasqyruar në materialin PDF, titulluar si “Regjistri i kërkesave për informacion për periudhën Korrik-Shtator 2023”.Aty dallohet se kërkesa jonë e regjistruar me nr.8, është bosh, e paplotësuar fare.

Ky zhvillim na ka fyer dhe na ka bërë të ndjehemi të përçmuar nga ky institucion publik. Jemi ndjerë të diskriminuar sepse jemi trajtuar në mënyrë të pafavorshme, të padrejtë, të paligjshme, krahasuar me një subjekt tjetër, në rrethana të njëjta, dhe si shkak për këtë trajtim mendojmë se është pozicioni ynë shoqëror, një organizatë rinore. Këtë diskriminim nga gjendja jonë shoqërore, e kemi identifikuar kur kemi mësuar jo zyrtarisht, se subjekti tjetër që Ministria e Kulturës, i ka ofruar shërbimin është një studio ligjore. Nëse vërtetohet ky fakt, jemi në rrethanat e një forme diskriminimi.

Ne si organizatë rinore nuk kemi të njëjtin pozicion shoqëror me një studio ligjore, e cila në aktivitetin e saj është ekspozuar si më e ndjeshme dhe më e aftë në mbrojtjen nga çdo shkelje ligjore. Por pavarësisht këtij dallimi, zbatimi i ligjit nr.119/2014 do të duhej të ishte i barabartë për ne dhe për subjektin tjetër, sepse dhënia e një shpërblimi nga një institucion publik (shërbim i garantuar me ligj) nuk duhet të bëhet në mënyrë selektive, duke trajtuar ndryshe të “*parrezikshmit*” (siç është rasti i organizatës sonë rinore) dhe të “*rrezikshmit*” (siç është rasti i studios ligjore).

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri, hetimin dhe verifikimin e rastit, për të konfirmuar shkeljen ligjore, si një rast konkret diskriminimi. Publikimin e rastit në faqen zyrtare të institucionit të Komisionerit, me qëllim informimin dhe sensibilizimin e opinionit të gjerë publik në radhë të parë, por dhe për institucionet publike, në nivel qendror dhe lokal, për ta parandaluar fenomenin e rrezikshëm potencial në çdo formë që mund të paraqitet në të ardhmen.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Qendra ABC Tirana Club, (në vijim Qendra) është një organizatë jofitimrurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr.1282, datë 30.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, Qendra ka si qëllim dhe fushë veprimtarie, ndër të tjera:- për të nxitur pjesmarrjen e komunitetit, veçanërisht të rinjve, në vendimarrjen e çdo niveli të qeverisjes; - mbështetjen maksimale për reformat që forcojnë dhe demokratizojnë insitucionet e çdo niveli dhe që shkojnë në favor të përmirësimit të kushteve të gjithanshme të jetesës së qytetarëve, në mënyrë të veçantë të rinjve; nxitjen e rezultateve konkrete në luftën për të parandaluar dhe goditur korrupsionin, krimin e organizuar dhe atë ordiner; - monitorimin e autoriteteve të qeverisjes në të gjitha nivelet, institucionet dhe agjencitë zbatuese për përmbushjen e detyrimeve ligjore; edukimin kulturor të popullatës, veçanërisht të rinjve, përmes njohjes dhe përhapjes së vlerave më të mira të kulturës kombëtare, etj.

Bazuar në ankesën e paraqitur pala ankuese, pretendon se është cenuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, si person juridik, pasi i është cenuar e drejta për të marrë informacion, sipas ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nga ana e Ministrisë së Kulturës.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet : *“1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”.....”*

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet : *“1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”*

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.*

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose*

interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës. 8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”*

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Qendra “ABC Tirana Club”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (në vijim LMD) dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi para Komisionerit, pasi pretendon se është cenuar në të drejtën e saj për të marrë informacion, si person juridik.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë Komisionerit, konstatohet se:

Ankuesi ABC Tirana Club, ka paraqitur ankesë pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim KDIMDHP) në datën 11.08.2023, me objekt “Ankim kundër refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Ministrisë së Kulturës. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, me vendimin Nr.46, datë 11.10.2023, KDIMDHP, ka vendosur të pranojë kërkesës dhe ka urdhëruar Ministrinë e Kulturës, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion të paraqitur nga pala. Pavarësisht vendimarrjes së KDIMDHP, pala ankuese shprehet se, Ministria e Kulturës nuk i ka vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar.

Pala ankuese ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar nga Ministria e Kulturës për shkak të gjendjes shoqërore. Pala ankuese pretendon se, është diskriminuar duke u trajtuar në mënyrë të pafavorshme, të padrejtë e të paligjshme nga ana e Ministrisë së Kulturës, krahasuar me një subjekt tjetër, që sipas saj gjendet në rrethana të njëjta me të, subjekt të cilit ndryshe nga pala ankuese i është vendosur në dispozicion informacioni i të njëjtës natyrë me atë të kërkuar prej saj, dhe si shkak për trajtimin të padrejtë dhe të pabarabrtë të cilit i është nënshtruar pala ankuese pretendon se është pozicioni i tyre shoqëror, si një organizatë rinore.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”,* Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji Nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjendjes shoqërore, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar*

në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrorë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a. Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese

në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Së pari, Komisioneri vlerëson se “*gjendja shoqërore*”, pretenduar nga pala ankuese si shkak diskriminimi, parashikohet shprehimisht si një shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD.

Së dyti, Komisioneri do të vlerësojë nëse, pretendimet e paraqitura nga ankuesi përfshihen në kuadër të shkakut të gjendjes shoqërore. Në praktikën e tij, për të vlerësuar pretendimet e ngritura në kuadër të shkakut të gjendjes shoqërore, Komisioneri i është referuar akteve të nxjerra nga organizma ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njerit, të cilat ofrojnë interpretime të akteve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut të cilat janë ratifikuar nga Shqipëria.

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara, i cili është organi përgjegjës për monitorimin dhe interpretimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, interpreton në Komentin e Përgjithshëm nr.20 “*Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*”, se *gjendja ekonomike dhe sociale* e individit përbën një shkak të ndaluar diskriminimi duke sqaruar se: “*Individët dhe grupet e individëve nuk duhet të trajtohen në mënyrë arbitrare për shkak se i përkasin një grupi apo shtrese të caktuar ekonomike apo sociale brenda shoqërisë. Gjendja sociale dhe ekonomike e një personi kur jeton në varfëri ose është i pastrehë, mund të rezultojë në diskriminim të përhapur, stigmatizim dhe stereotipe negative që mund të çojnë në refuzimin ose aksesin e pabarabartë për të njëjtën cilësi të arsimit dhe kujdesit shëndetësor si të tjerët, si dhe mohim ose akses të pabarabartë në vendet publike*”.

Gjithashtu, në Kanada, Karta e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Kebekut (Québec Charter of Human Rights and Freedoms) përfshin “*gjendjen shoqërore*” (social condition) si një nga shkaqet e ndaluara të diskriminimit. Komisioni i të Drejtave të Njeriut në Kebek, (Québec Commission des droits de la personne et des droits de la jeunesse) ka përcaktuar se ky shkak “*i referohet një shkalle, një pozicioni shoqëror ose një klase që i atribuohet dikujt, kryesisht në bazë të nivelit të të ardhurave, punësimit dhe nivelit arsimimit të tyre*”².

Komisioneri vlerëson se, *shkaku i gjendjes shoqërore*, i referohet situatës së një personi në shoqëri ose të prezumimit të përkatësisë në një pozicion të caktuar shoqëror, në të cilën personi gjendet si pasojë e nivelit të të ardhurave, aspekteve që kanë të bëjnë me përkatësinë në një profesion të caktuar dhe punësimin, përfshi këtu edhe situatën e papunësisë, si dhe aspekte që kanë të bëjnë me nivelin arsimor të personit. Ky shkak mbron kryesisht personat që janë të pafavorizuar për shkak të pozitës së tyre shoqërore. Kriteret e mësipërme, për të vlerësuar gjendjen shoqërore të një personi, nuk janë shteruese apo kumulative, dhe se do të mjaftonte

² Raporti i Raportuesit Special për varfërinë ekstreme dhe të drejtat e njeriut, Olivier De Schutter. Ndalimi i diskriminimit për shkak të disavantazhit socio-ekonomik: një mjet thelbësor në luftën kundër varfërisë, 13 korrik 2022: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N22/423/82/PDF/N2242382.pdf?OpenElement>

vetëm ekzistenca e vetëm njërit prej disavantazheve të mësipërme, në mënyrë që të provohet shkak i gjendjes shoqërore.³

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese pretendon se, gjendja shoqërore, ka të bëjë me pozicionin e tyre shoqëror, si një organizatë rinore. Pala ankuese, pretendon se, subjekti që ka marrë informacionin nga ana e Ministrisë së Kulturës, është një studio ligjore dhe sipas tyre, është e ekspozuar si më e ndjeshme dhe më e aftë në mbrojtjen nga çdo shkelje ligjore, e për këtë arsye pala ankuese si një organizatë rinore nuk kanë të njëjtin pozicion shoqëror. Sipas tyre, rasti i organizatës së tyre rinore është trajtuar ndryshe pasi janë konsideruar si të “parrezikshmit” ndryshe nga rasti i studios ligjore që janë konsideruar si të “rrezikshmit”.

Komisioneri, vlerëson se, qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së palës ankuese si një organizatë jofitimprurëse, e cila është e fokusuar tek çështjet që kanë të bëjnë me rininë, por jo vetëm, nuk tregon për gjendjen shoqërore të këtij subjekti, por tregon objektin dhe fushën e veprimtarisë së kësaj organizate jofitimprurëse.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, pavarësisht se shkak i gjendjes shoqërore i pretenduar nga pala ankuese, është një shkak i ndaluar/mbrojtur nga diskriminimi, pretendimet e paraqitura nga ankuesi, nuk mund të përfshihen në kuadër të shkakut të gjendjes shoqërore. Për rrjedhojë Komisioneri, vlerëson se, nuk provohet ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, “gjendja shoqërore”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nuk hyn në kompetencën e këtij institucioni, shqyrtimi i pretendimeve që ankuesi ka ngritur kundër Ministrisë së Kulturës për mosdhënie të informacionit sipas parashikimeve të ligjit nr.119//2014 “Për të drejtën e informimit”. Pala ankuese duhet të ndjekë hapat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi që rregullon garantimin e të drejtës për informim, për të kërkuar rivendosjen në vend të të drejtës së pretenduar si të cenuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, gjithë sa më sipër dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nr. 2, datë 11.01.2024, e paraqitur nga Qendra “ABC Tirana Club, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

³ Shiko Vendim Nr.49, datë 03.04.2023, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr.2, datë 11.01.2024, të paraqitur nga pala ankuese Qendra ABC Tirana Club, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja shoqërore
Fusha: Të mira dh shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim